

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Frosina Sylejmani kryetare, Fejzullah Rexhepi dhe Isa Shala anëtarë, në çështjen juridike të paditësit B.J. nga fshati F.E. / Glllogovc, të cilin me autorizim e përfaqëson H.B. avokat nga Glllogovci, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “NN”, sh.a me seli në Prishtinë të cilën e përfaqëson me autorizim B.D., në çështjen për kompensim të dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Glllogovc, C.nr.62/10 të datës 02.07.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 05.09.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht ankesa e të autorizuarit të paditurës Kompania e Sigurimeve “NN”, në Prishtinë, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Glllogovc C.nr.62/10 i datës 02.07.2014, në pikën I të dispozitivit lidhur me kompensimin e dëmit jo material për dhimbje fizike dhe për frikë të përjetuar ashtu që vendoset, DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “NN” sh.a me seli në Prishtinë që paditësit B.J. nga fshati F.E. / Glllogovc në emër të kompensimit të dëmit jo material të shkaktuar në aksidentin e datës 01.02.2010 t’ia paguaj shumat dhe atë: Për dhimbje të përjetuara fizike shumë prej 1.300 euro dhe për frikë të përjetuar shumë prej 1.000 euro ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë për dëmin jo material në emër të dhimbjeve fizike dhe frikës së përjetuar përtej shumës së gjykuar refuzohet e pabazuar.

II. NDRYSHOHET pjesa që ka të bëjë me kamatën si në një pjesë të dispozitivit ashtu që gjykon dhe duhet të jetë: me kamatë e cila vlenë si për mjetet e deponuara në bankat që operojnë në Kosovë, në afat prej një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë datë 02.07.2014, e deri në pagesën përfundimtare.

III. REFUZOHET pjesërisht e pabazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “NN” me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë–Dega në Glllogovc C.nr.62/10 i datës 02.07.2014 në pjesën tjetër të dispozitivit për shkak të dëmit material në emër të ushqimit të përforcuar, VËRTETOHET.

IV. Mbetet e pashqyrtuar pjesa që ka të bëjë me refuzimin e kërkesëpadisë në pikën II të dispozitivit.

A r s y e t i m

Me Aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës së shkallës së parë, C.nr.62/10 të datës 02.07.2014, me pikën I të dispozitivit është aprovuar pjesërisht kërkesëpadia e paditësit B.J. nga fshati F.E. / Glllogovc dhe është detyruar e paditura KS “NN”sh.a.me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të dëmit jo material dhe material të shkaktuar si pasojë e lëndimeve të marra në aksidentin e shkaktuar më datë 01.02.2010, t’ia paguaj shumat dhe atë në emër të dëmit jo material: për

dhimbje fizike shumë prej 2.150 euro, për frikën e përjetuar shumë prej 1.500 euro dhe në emër të dëmit material : për ushqim të ushqimit të përforcuar shumë prej 50 euro, të gjitha këto shuma me kamatë vjetore prej 3.5% duke filluar nga dita e marrjes së Aktgjykimit e deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet procedurale në shumë 799 euro të gjitha këto në afat prej 15 ditësh që nga dita e formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcnimin e përmbarimit me dhunë.

Me pikën II të dispozitivit është refuzuar kërkespadija e paditësit mbi lartësinë e aprovuar për dëmin jomaterial : në emër të frikës shumë prej 500 euro si dhe kërkespadija lidhur me dëmin material në emër të emër të ndihmës dhe kujdesit nga personi i tretë në shumë prej 100euro si dhe shpenzimet për rehabilitim klimaterik në shumë prej 140 euro.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë e paditura Kompania e Sigurimeve “NN” sh.a në Prishtinë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitivit të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë –Dega në Glllogovc C.nr.62/10 të datës 02.07.2014 dhe çështja të vendoset nga gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë.

Paditësi në përgjigjë në ankesë përmes të autorizuarit të tij, ka kundërshtuar pretendimet ankimore të të paditurës, me arsyetim se Aktgjykimi i nxjerrë nuk përmban shkelje të dispozitivit kontestimore ngase është nxjerrë mbi bazën e provave materiale duke provuar faktet relevante, dispozitivi i aktgjykimit është i qartë, i ekzaminueshëm dhe i arsyetuar mbi bazën e fakteve të provuara me prova të administruara, mbi bazën e të cilave është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë dhe gjendja faktike duke aprovuar pjesërisht kërkespadinë e paditësit me aplikim të drejtë të së drejtës materiale, nga të cilat arsye i ka propozuar gjykatës së Apelit që në tërësi të refuzohet Ankesa e paraqitur nga e paditura dhe të vërtetohet Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë Cnr.62/10 datë 02.07.2014.

Gjykata e Apelit pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, lidhur me Aktgjykimin e atakuar, konform dispozitivit të nenit 194,195 dhe nenit 200 të LPK-ës, gjeti se:

Ankesa e të paditurës është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi B.J. nga fshat F.E. / Glllogovc me datë 15.04.2010 ka ushtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “NN” sh.a me seli në Prishtinë, të precizuar me anë të parashtresës datë 24.06.2014 me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “NN” sh.a në Prishtinë, që paditësit në emër të dëmit jo material dhe material si pasojë e aksidentit të datës 01.02.2010 t’ia kompensoj shumat dhe atë për dhimbje fizike shumë prej 2.150 euro, për frikën e përjetuar shumë prej 2.000 euro, për ndihmë nga personi i tretë shumë prej 100 euro, për ushqim të përforcuar shumë prej 50 euro, për rehabilitim klimaterik shumë prej 140 euro, me kamatë ligjore të cilën e paguajnë bankat për mjetet e afatizuara mbi një vit, duke filluar nga data e ushtrimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto nga dita e pranimit të Aktgjykimit në afat prej 15 ditësh, nën kërcnim të përmbarimit.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës konform dispozitivit të nenit 8 të LPK-ës, ka nxjerrë Aktgjykimin Cnr.62/10 datë 02.07.2014 duke aprovuar pjesërisht

kerkesëpadinë e paditësit, mbështetur në dispozitat e nenit 154.1, 158.1, 178.1, 200.1 dhe 2 të LMD-ës.

Në aryetimin e Aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se me datë 01.02.2010 ne rrugën magjistrale Prishtinë- Pejë në vendin e quajtur Krivovë, ka ndodhur aksident trafiku, ku drejtuesi i makinës së tipit Golf me targë 414 KS 152 A.P., i siguruar pranë të paditurës me polise sigurimi 0009458805, nga pakujdesia duke mos e përshtatur lëvizjen kushteve të rrugës dhe rregullave të komunikacionit dukë ngasë makinën në kahje të kundërt të drejtimit, ka goditur makinën e tipit B-VË kombi 70XOBT4 me targë 102 KS 409 të cilën në momentin e shkakimit të aksidentit po e drejtonte paditësi B.J., i cili si pasojë e goditjes ka pësuar lëndime të lehta trupore.

Lidhur me bazën juridike të kërkespadiës gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se e njëjta gjatë shqyrtimit kryesorë nuk ishte kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse .

Ndërsa për natyrën e lëndimeve që ka pësuar paditësi dhe vërtetimin e lartësisë së kërkespadiës gjykata e shkallës së parë ka marrë për bazë ekspertizat mjekësore të përpiluara nga ekspertë mjekësore nga lëmia e ortopedisë –traumatologjisë dr S.D. dhe nga lëmia e psikiatrisë dr. S.G.-B., mendime këto të dhëna në seancën e mbajtur gjyqësore me datë 23.06.2014, pas ekzaminimit direkt të palës se dëmtuar dhe vlerësimit të dokumentacionit mjekësore.

Nga mendimi i përbashkët i eksperteve mjekësorë është konstatuar se paditësi në aksidentin e datës 01.02.2010 ka pësuar ndrydhje të regjionit të gjoksit, ndrydhje të regjionit të krahut të majte, ndrydhje të regjionit të dy gjunjëve, të cilat kualifikohen si lëndime të lehta trupore, e si pasojë e të cilave paditësi ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 48 orësh, dhimbje fizike të shkallës së mesme në kohëzgjatje prej tre javësh, dhimbje fizike të intensitetit të ulët prezentë edhe në momentin e ekzaminimit gjatë sforcimeve fizike dhe ndryshimeve klimaterike, ka përjetuar frikë primare e cila ka zgjatur për disa sekonda sepse paditësi ka qenë në rolin e ngasësit të makinës dhe ka parë drejtë përdrejt ndodhjen e aksidentit, pastaj frikë sekondare të intensitetit të lartë e shoqëruar me shqetësime, ankthë që ka zgjatur një orë si dhe frikë sekondare e intensitetit të mesëm e cila ka zgjatur për dy javë, ndërsa frika e intensitetit të ulët ka zgjatur edhe për katër javë e përcjellur me simptome të reagimit akut të stresit, qregullim në gjumë, qregullime në disponim, ankesa trupore dhe rikujtim të ngjarjes traumatike, gjithashtu kanë konstatuar se ka pas nevojë për ndihmë nga personi i tretë në kohëzgjatje prej tri javësh si dhe ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej dy javësh si dhe nevojë për rehabilitim klimaterik për dy javë në vitin e parë dhe katër javë pas vitit të parë të aksidentit.

Duke u nisur nga kjo gjendje faktike e vërtetuar, Gjukata e shkallës së parë ka gjetur se kërkespadija e paditësit për dëmin jo material dhe material është pjesërisht e bazuar ku dhe ka vendosur si në pikën I dhe II të dispozitivit të aktgjykim të ankimuar. Mënyrën e vendosjes lidhur me dëmin jo material dhe material të gjykuar paditësit, gjykata e shkallës së parë e ka bazuar duke ju falë besimin mendimit profesionalë të dhënë nga ekspertë mjekësorë si dhe provave tjera nga shkresat e lëndës, mbështetur në dispozitat e nenit 178.1, 200.1 dhe 2 të LMD-ës, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në dispozitën e nenit 452.2 të LPK-ës.

Lidhur me pjesën e refuzuar të kërkespadiës rreth dëmit jomaterial në emër të frikës së përjetuar përtej shumës së gjykuar dhe dëmit material për ndihmë nga personi i tretë dhe shpenzime të

rehabilitimit, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se këtë pjesë të kërkesëpadisë paditësi nuk ka argumentuar me prova përkundër që ka qenë i obliguar që të argumentoj më prova ë gjitha faktet e pretenduara, konform nenit 7 të LPK-ës.

Gjykata e Apelit, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-ss ka konstatuar se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje nga neni 182.2 pika b), g), j) k) dhe m) për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe nuk përmban as shkelje tjera procedurale sipas pretendimeve ankimore të të paditurës të parashtruara përmes ankesës.

Pretendimi i ankimore i të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të nenit 182.2 pika n) të LPK-ës, për faktin se aktgjykimi i ankimuar është i pakuptueshëm dhe kontradiktorë me arsyetimin e aktgjykimit dhe nuk janë treguar fare arsye për faktet vendimtare, për gjykatë e Apelit, është pretendim i pathemelt ngase kjo gjykatë konsideron se aktgjykimi i atakuar është mjaft i qartë si në pjesën e dispozitivit edhe të arsyetimit dhe është në përputhje të plotë me përmbajtjen e kërkuar me dispozitat e nenit 160 të LPK-ës ku edhe ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare lidhur me mënyrën e vendosjes.

Lidhur me pjesën e ndryshuar të aktgjykimit të atakuar sa i përket demit jo material në emër të dhimbjeve fizike dhe frikës së përjetuar, gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të dispozitës së nenit 195 paragrafi 1 pika e) lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika d) të LPK-ës., sepse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontetimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje të vërtetuar faktike nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale.

Në cdo rast për demin jo material gjykata duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimin të cilit i shërben ky kompensim, mbi këto bazë gjykata duke pas parasysh lëndimet e pësura paditësi në regjione të shumta trupore, intensitetin, kohëzgjatjen e pasojave të demit vlerësoj se shuma prej 1.300 euro në emër të demit jo material për dhimbjet e përjetuara fizike dhe shuma prej 1.00 euro në emër të frikës së përjetuar është në hamroni me qëllimin e kompensimit, ndërsa kërkesa përtej shumës së gjykuar tejkalon qëllimin e kompensimit.

Lidhur me lartësinë e kompensimit të demit për këto lloje të demit, gjykata mori parasysh edhe praktikën e deri tanishme gjyqësore duke u siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfacion për paditësin duke shmangur qëllimet tjera materiale që mund të bien ndesh me qëllimin e kompensimit.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit duke e vërtetuar aktgjykimin e atakuar për kompensimin e demit material për shkak të ushqimit të përforcuar në shmë prej 50 euro, duke vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejt për këtë kategori të demit në atë mënyrë që shuma e gjykuar është në përputhje me praktikën gjyqësore për këtë kategori demit.

Lidhur me kamatën është ndryshuar Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë konform dispozitës së nenit 277 të LMD-es ashtu që është gjykuar: me kamatë e cila vlen si për mjetet e deponuara në bankat që operojnë në Kosovë, në afat prej një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë datë 02.07.2014, e deri në pagesën definitive.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka pasur parasysh edhe pretendimet ankimore të të paditurës përmes ankesës së ushtruar, ku kjo gjykatë me aprovimin e pjeshëm të pretendimeve ankimore të të paditurës ka ndryshuar aktgjykimin e ankimuar duke vendosur si në pikën I të këtij aktgjykimi, për arsyet e cekura si më lartë, ndërsa për atë pjesë të pretendimeve të cilat nuk janë marrë parasysh, kjo gjykatë ka gjetur se janë të pathemelta dhe pa ndonjë ndikim për të vendosur ndryshe nga ajo që është vendosur në këtë Aktgjykim.

Pjesa e refuzuar e dispozitivit (ne pikën II të Aktgjykimit ta atakuar) nuk është shqyrtuar sepse ankesa nuk ka qenë e drejtuar përkitazi me pjesën e refuzuar te kërkesëpadisë.

Mbi bazën e te theksuarave u vendos si ne dispozitiv te këtij Aktgjykimi, konform dispozitave të nenit 194, 195 parag.1 pika d) dhe e) lidhur me nenin 200 të LPK-ës .

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3791/14 më datë 05.09.2017

KRYETARJA E KOLEGJIT
Frosina Sylejmani